

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 10.06.2022, në Tiranë midis palëve të mëposhtme lidhet kjo kontratë (në vijim "Kontrata") me kushtet dhe afatet si më poshtë:

**Z. Klenti Budina**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 19.01.1976, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033663699 dhe numër personal H60119114S, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar (në vijim referuar si "Shitësi")

- nga njëra anë -

dhe

**Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rrugë "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa Nr.12, Kati 11<sup>te</sup>, Zyra nr.1206, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 025864525, dhe me numër personal I35203147R (në vijim referuar si "Blerësi")

- nga ana tjetër -

### DUKE QENË SE:

- (A) Shitësi është pronar i një kuote ("Kuota") që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., themeluar sipas legjislacionit shqiptar më 11.07.2018, me numër NUIS L81911036L dhe seli në adresën: Rrugë "Luigj Gurakuqi", Pallati 89, Shkalla 1, Tiranë Shqipëri (në vijim referuar si "Shoqëria").
- (B) Shitësi dëshiron të shesë tek Blerësi Kuotën dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi të gjithë Kuotën.

Bazuar në dakordësinë e arritur mes tyre, Palët bien dakord për kushtet dhe afatet e Kontratës si vijojnë:

#### 1. OBJEKTI I KONTRATËS

- Objekt i kësaj Kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës dhe titullit të pronësisë mbi të nga Shitësi tek Blerësi në përputhje me parashikimet e mëposhtme.
- Blerësi nuk do të mbartë dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi dhe pasojë financiare, ligjore ose penale në lidhje me cilindro detyrim, penalitet, shkelje, parregullesi ose mospërputhje me ligje, akte nënligjore dhe rregullore të cilat mund të rezultojnë nga çdo lloj kontrolli ose inspektimi apo pretendimi i të tretëve në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë për periudhën kur Shitësi ka patur pronësinë e kuotës së Shoqërise dhe/ose para kësaj periudhe. Të gjitha këto përgjegjësi dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me sa me lart, do t'i ngarkohen Shitësit.
- Me kalimin e pronësisë së Kuotës te Blerësi, ky do të jetë ortak i vetëm i Shoqërisë duke zotëruar plotësisht Kuotën që përbën të gjithë kapitalin e Shoqërisë.

## **2. ÇMIMI I BLERJES SË KUOTËS, MËNYRA E PAGESËS DHE KALIMI I PRONËSISË**

- a) Çmimi i Kuotës që do të paguhet nga Blerësi është 150,000.00 Lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë) ("Çmimi i Blerjes").
- b) Blerësi do t'i paguajë Shitësit Çmimin e Blerjes në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- c) Pronësia mbi Kuotën në Shitje do të kalojë në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe do të formalizohet në momentin e regjistrimit në regjistrin e shoqërive tregtare të mbajtur nga Qendra Kombëtare Biznesit.
- d) Pa paragjykuar përgjithësimin e parashikuar në paragrafin (b) të nenit 1 këtu më lart, dhe për hir të qartësisë, Blerësi mbetet pernjegjës ndaj Shitësit për shlyerjen e huave që ky i fundit i ka dhënë kohë pas kohe Shoqërisë, në vlerën totale 828,658.00 Lekë (tetëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë). Blerësi angazhohet t'i paguajë Shitësit vlerën e lartpërmendur brenda 1 jave nga data e kalimit të pronësisë së Kuotës në emrin e Blerësit dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë si më lart në regjistrin tregtar.

## **3. DEKLARIMET E GARANCITË E SHITËSIT**

- a) Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklarimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta si në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ashtu dhe në datën e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas Nenit 2 këtu më sipër.
- b) Kuota në pronësi të Shitësit përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- c) Shitësi gjëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontrate dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- d) Shitësi garanton që Kuota është e lirë dhe mbi të nuk rëndon asnjë barrë e çfarëdolloji qoftë (përfshirë por pa u kufizuar në barrë siguruese/peng apo ndonjë formë tjetër barrësimi ligjor) në favor të palëve të treta, private apo shtetërore.

## **4. DEKLARIMET E GARANCITË E BLERËSIT**

- a) Blerësi, deklaron dhe garanton ndaj Shitësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklarimet në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- b) Blerësi është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe që vepron në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi.
- c) Blerësi gjëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontrate dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme në lidhje me nënshkrimin e kësaj Kontrate me këto kushte dhe afate.
- d) Blerësi pranon se përpara nënshkrimit të Kontratës i është dhënë mundësi e plotë për të marrë informacionin e nevojshëm në lidhje me Shoqërinë në mënyrë që të marrë një vendim të informuar në lidhje me këtë transaksion.

## **5. DËMSHPËRBLIMI**

- a) Në rast se Çmimi i Blerjes nuk kreditohet në favor të Shitësit sipas parashikimeve të nenit 2.2, kjo Kontratë konsiderohet e zgjidhur automatikisht dhe nuk krijon asnjë pasojë ligjore për palët të cilat do të kthehen në gjendjen e mëparshme.

- b) Në rast se ndonjëra palë nuk përbush detyrimet e veta sipas kësaj Kontrate dhe/ose shkel deklarimet dhe garancitë e dhëna përkatësisht në nenet 3 dhe 4, atëherë pala tjetër ka të drejtë të zgjidhë Kontratën dhe të kërkojë çdo humbje apo dëmshpërblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve dhe/ose shkeljeve të palës që është në kushtet e mospërmbushjes.

## 6. KOSTOT

Çdo tarifë, taksë ose tatum që duhet paguar, nëse do të ketë të tilla si rezultat i zbatimit të kushteve të kësaj Kontrate dhe i transferimit të pronësisë së Kuotës në Shitje, do të paguhet plotësisht nga pala që ka detyrimin ligjor dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohet shpenzimi përkatës, ato ndahanë në mënyrë të barabartë midis palëve.

## 7. LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohen në përputhje me ligjet shqiptare.

## 8. JURIDIKSIONI

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë sa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë së saj, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 9. TË NDRYSHME

- a) Asnjë ndryshim ose shtesë e kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk kryhet me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose përllogari të Palëve.
- b) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo Kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtarëve të palëve.
- c) Në rast se në çdo kohë, ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, kjo nuk do të cënojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të Kontratës dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës.


## 10. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI

Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe, në dy njësi origjinale, secila me të njëjtën vlerë.

## PALËT

**SHITËSI**  
Z. KLENTI BUDINA

**BLERËSI**  
BALFIN - Balkan Finance Investment Group SHPK






SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K.  
Papa Gjon Pali II Str., ABA Business Center, 11<sup>th</sup> Floor, Tiranë, Shqipëri  
*Registruar pranë regjistrat tregtar me numër identifikimi*  
K72223031K

---

**VENDIM**  
**I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË**

Sot, më 10.06.2022, në orën 10.00, në selinë qendrore të Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k. (këtëj e tutje referuar si "Shoqëria"), u mbajt Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Shoqërisë.

I pranishëm në këtë mbledhje është ortaku i vetëm i Shoqërisë, **Z. Samir Mane**, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, Shqipëri, më datë 24.12.1967, me vendbanim në adresën: Kompleksi Rezidencial Rolling Hills, Mullet, Tirana, Albania, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030866691 ("Ortaku i Vetëm").

Ortaku i vetëm, i cili merr përsipër drejtimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, fton Znj. Migena Kolonja, e cila pranon, të kryejë funksionin e Sekretarit të Mbledhjes.

Kryetari i Asamblesë pasi shpreh vullnetin e Ortakut të vetëm për të vendosur mbi Rendin e Ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për mbledhje, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të mbledhur rregullisht, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", dhe mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me Rendin e Ditës si më poshtë vijon:

**REND DITE**

- I. Miratimi i blerjes së një kuote që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., themeluar dhe regjistruar me numër NUIS L81911036L nga ortaku i vetëm i kësaj shoqërie Z. Klenti Budina me një çmim blerjeje prej 150'000.00 Lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë).
- II. Miratimi i lidhjes së Kontratës së Shitjes së Kuotës që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., mes Shoqërisë në cilësinë e Blerësit dhe Z. Klenti Budina në cilësinë e Shitësit, sipas kushteve të dakordësuara mes palëve paraprakisht.
- III. Autorizimin e Administratorit të Shoqërisë Znj. Edlira Muka që të përfaqësojë Shoqërinë në lidhjen e Kontratës së Shitjes së Kuotës si më sipër, dhe të nënshkruar atë kontratë në emër e për llogari të Shoqërisë.

\*\*\*\*\*

Duke kaluar në diskutimin Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se Asambleja po vlerëson blerjen dhe transferimin e pronësisë tek Shoqëria, të një kuote që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., themeluar dhe regjistruar me numër NUIS L81911036L nga ortaku i vetëm i kësaj shoqërie Z. Klenti Budina.

Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k. do të blejë Kuotën e shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., nga ortaku i vetëm i saj Z. Klenti Budina, sipas draftit të Kontratës së Shitjes së Kuotës bashkëlidhur këtij vendimi, me një çmim blerjeje **150'000.00 Lekë** (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë).

Palët kanë rënë dakord që Shoqëria nuk do të mbartë dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi dhe pasojë financiare, ligjore ose penale ne lidhje me çfarëdo lloj detyrimi, penaliteti, shkeljeje, parregullesie ose mospërputhjeje me ligje, akte nënligjore dhe rregullore të cilat mund të rezultojnë në lidhje me aktivitetin e shoqërisë GO GREEN Sh.p.k. për periudhën kur Shitësi ka patur pronësinë e Kuotës së Shoqërise dhe/ose para kësaj periudhe.

Pas një shqyrtimi të kujdeshëm të çeshtjeve në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë blerjen e një kuote që 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., themeluar dhe regjistruar me numër NUIS L81911036L, nga ortaku i vetëm i kësaj shoqërie Z. Klenti Budina me një çmim blerjeje prej 150'000.00 Lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë).
- II. Të miratojë lidhjen e Kontratës së Shitjes së Kuotës që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GO GREEN Sh.p.k., mes Shoqërisë në cilësinë e Blerësit dhe Z. Klenti Budina në cilësinë e Shitësit, sipas kushteve të dakordësuara mes palëve paraprakisht dhe sipas draftit bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë Znj. Edlira Muka që të përfaqësojë Shoqërinë në lidhjen e Kontratës së Shitjes së Kuotës si më sipër, dhe që të nënshkruajë atë kontratë në emër e për llogari të Shoqërisë si edhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për ekzekutimin e saj.

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çeshtje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.30.

\*\*\*\*\*

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË  
BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K.**

Kryetar / Ortak i vetëm

Z. Samir Mane



Sekretar

Znj. Migena Kolonja

-2-

